



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:174842
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05840813

K.DH.SH.II.nr.537/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni” SH.A., me NUI: 811324152, me seli në rr. “Tahir Sinani”, Nr. 59, Njësia Operative në Malishevë, kundër debitorit “MORINA” Automekanik I.M., me seli në Malishevë, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1288/23 të datës 31.10.2023, me datën 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ekoregjioni” Sh.A, me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1288/23 të datës 31.10.2023 **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1288/23 të datës 31.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “MORINA”

Automekanik I.M. ashtu që Anulohet Urdhri Përmbartimor P.nr. 362/23, i lejuar më datë 24.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, Përfundohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, P.nr. P.nr.362/2023 të datës 24.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së konsumatorit Nr. 753419 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga kartela e konsumatorit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 905.97 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur brenda afatit ligjor prapësim me të cilin e ka Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se kërkesa e kreditorit është parashkruar sipas Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), ngase nuk mund të kërkohet

ekzekutimi nëse kanë kaluar më tepër se 1 vit. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet urdhri i përmbaruesit privat. Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se propozimi për përmbarim i lejuar nga përmbaruesi privat i përmban të gjitha kriteret e përmbarueshmërisë për t'u konsideruar si dokument i besueshëm. Në lidhje me pretendimet e debitorit se kërkesa e borxhit është parashkruar e njëjta nuk qëndron, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me biznes. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i palejueshëm dhe i pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohej në tërësi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e konsumatorit Nr. 753419, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Duke shtuar se sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetary”, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Ndërsa, me dispozitën nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”. Po ashtu ka cek se nga kjo dispozitë, gjykata gjen se në rastin

konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe nuk është treguar në mënyrë të saktë nëse propozimi është paraqitur ndaj dy debitorëve të përmbarimit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit. Andaj, duke qenë se urdhri përmbarimor është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbarimor.

Andaj Dhoma e Shkallës së Parë gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është lejuar dokumentit të besueshëm –kartela financiare - ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës Nr. 753419, figuron periudha kohore prej datës 01.01.2019 ku edhe borxhi fillestar rezulton të jetë 561.44 €, deri tek data 30.06.2023 ku vlera e borxhit është 905.97 €, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit të tyre para periudhës 01.01.2019, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm - Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatori 753419, figuron periudha kohore prej datës 01.01.2019 ku edhe borxhi fillestar rezulton të jetë 561.44 €, deri tek data 30.06.2023 ku vlera e borxhit është 905.97 €, ndërsa në

përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit të tyre para periudhës 01.01.2019, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Kjo gjykatë vlerësoj pretendimet ankimore mirëpo nuk kishin ndikim në vendoje ndryshe në këtë çështje përmbartimore.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.537/24, me datë 20.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitja Ymeri